



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS**  
**KOMISIONI I ZGJEDHJEVE TË FAKULTETIT TË BUJQËSISË DHE MJEDISIT**

**NJOFTIM**

Në mbledhjen e datës 29/04/2024, KZF shpalli fillimin e procesit të regjistrimit për kategorinë Dekan/Përgjegjës të njësisë bazë/departament dhe Qendrën e Kërkimit, Institutin e Resurseve Gjenetike të Bimëve (IRGJB).

Regjistrimet do të kryhen pranë sekretarisë së KZF (Salla 101, Godina Agronomisë). Data e fillimit të regjistrimit është 13/05/2024, dhe data e përfundimit është 17/05/2024, përgjatë orarit 08.00-16.00

**Kriteret për drejtues të njësisë kryesore në baze të nenit 22 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në UBT”**

Kandidatët për drejtues të njësisë kryesore në FBM i përkasin kategorisë "Profesor" dhe mund të vijnë nga radhët e personelit akademik të tij ose jashtë tij. Kandidatët për drejtues të njësisë kryesore vetëkandidohen dhe duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- të kenë përvojë në mësimdhënie ose kërkim shkencor jo më pak se 10 (dhjetë) vjet;
- të kenë përvojë akademike në cilësinë e titullarit të disiplinave të lëndëve, si dhe të kenë zhvilluar programe lëndësh, të kenë përgatitur literaturë mbështetëse dhe ose të kenë zhvilluar projekte kërkimore etj., prej të paktën 5 (pesë) vjetësh.

Nuk mund të kandidojnë për drejtues të njësisë kryesore në UBT, kandidatët që:

- Janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal;
- Janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Janë të dënuar më parë për vepra penale;
- Ndaj tyre është dhënë masë disiplinore;
- Nuk kanë marrë vlerësim pozitiv në lidhje me ligjshmërinë e përfitimit të gradave dhe titujve akademik si dhe në vlerësimin e kontrollit antiplagjiaturë nga ana e Këshillit të Etikës.

- Kanë qenë drejtues të njësisë kryesore të zgjedhur për dy ose më shumë mandate të njëpasnjëshme apo të ndara në të njëjtin institucion ku do të kandidojnë.
- Kanë mbushur moshën për pension sipas nenit 65 të ligjit *nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*.
- Kanë papajtueshmëri në kuptim të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" dhe ligjit nr. 138/2015 "*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*"
- Kandidojne per autoritete te tjera drejtuese

**Dokumentacioni që duhet të depozitohet në bazë të nenit 25 te Rregullores "Per organizimin e zgjedhjeve per autoritetet dhe organet drejtuese ne UBT"** është si më poshtë vijon:

- Kërkesën për kandidim, e cila përmban, emrin; atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë; shprehjen e vullnetit për kandidim;
- Deklarimin se kandidati nuk ka fituar dy mandate si autoritet drejtues në postin për të cilin kërkon të kandidojë;
- Dëshminë e penalitetit (shkarkohet ne e-albania);
- Deklarimin se nuk ka shkak për të qënë objekt i ligjit nr. 138/2015 "*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*" dhe ligjit nr. 45/2015 "*Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*";
- Kopje të dokumentit të identifikimit;
- Kopje të noterizuar të titullit akademik;
- Vërtetimin e verifikimit të ligjshmërisë së dosjes të promovimit akademik dhe vlerësimin antiplagjiaturë për kandidatët e të gjitha niveleve për autoritete dhe organet drejtuese të UBT, të lëshuar nga Këshilli i Etikës së UBT-së;
- Dokumentin që vërteton vendin ku kandidati është i punësuar dhe vitet e punësimit.

**Kryetari i KZF**

**Jolia KORITA**